
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Zyra e Personelit Kancelarija za Osoblje		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	02 Nr. 34/20	Data: 12.06.2020	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me Marrëveshje për Shërbime te veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Vendi i Punës: Operator Teknik

Nr. i referencës: 02Nr. 34/20

Lloji i Pozitës: Marrëveshje për Shërbime te Veçanta - kohëzgjatja 6 muaj,

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Orari i plotë: 40 orë ne javë

Paga 400 €

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbanë kontakte të rregullta me punonjësit në të gjitha nivelet e institucionit, stafit komunal ofrimin e ndihmës për çështje ose këmbim të informatave;
- Ndihmon stafin profesional dhe drejtues në një numër të detyrave të rëndësishme teknike administrative;
- Përpilon raporte ditore në librin e shërbimit për problemet e shfaqura teknike gjatë operimit;
- Është pjesëmarrës në aktivitetet e ndryshme operative në kuadër të emergjencave;
- Kryen punë dhe detyra tjera nga fushë veprimtaria e sektorit emergjent në përputhje me ligjin;
- Obligohet që të informoi mbikëqyrësin për parregullsitë që hasë gjatë operimit;
- Sipas nevojave dhe kërkesës së mbikëqyrësit kryen edhe punë tjera shtesë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :

Të drejtë konkurimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për te vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë

profesionale për kryerjen e detyrave dhe te cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Dokumentet:

- Dëshmi të kualifikimit shkollor, shkolla e mesme teknike
- Dy rekomandime
- Dokument identifikimi
- Certifikata e lindjes ose ekstrakti
- Të ketë 3 vite përvojë pune
- Certifikata qe nuk jeni nën hetime

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit 12.06.2020 deri më 19.06.2020

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës "

Kërkesat e dërguara pas datës se fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do te pranohen.



Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi